



KONFEDERATA E SINDIKATAVE TE SHQIPERISE
CONFEDERATION OF THE TRADE UNIONS OF ALBANIA

Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“NË MBËSHTETJE TË ANTARSIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN”

Zgjerimi i Bashkimit European edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, e veçanërisht për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, është një proces inkurajues, i cili udhëhiqet nga kritere aderimi objektive, të qarta dhe të prekshme. Bazuar në shkallën e realizueshmërisë së kritereve, Ne, jemi të bindur se vullneti dhe vizioni i vendeve anëtare të Bashkimit European për ta pranuar Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut brenda familjes së saj të madhe do të jetë shumë shpejt një realitet i prekshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë.

Njëkohësisht, jemi të bindur se ky proces kalon nëpërmjet zbatimit të një sërë reformash nga vendi ynë. Reforma të cilat për nga rëndësia do ti konsideronim “jetike” dhe që e lidhin veprimtarinë e tyre më garantimin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe qëllimin kryesor të kësaj reforme, vendosjen e drejtësisë pa artifica të cilët e dëmtojnë rëndë organizimin dhe funksionimin e drejtësisë, reformimin e ekonomisë dhe garantimin e respektimit në mënyrë absolute të të drejtave dhe lirive themelore të njeritut përgjithësisht dhe të punonjësve në veçanti.

Nëpërmjet kësaj Rezolute, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë mbështet gjithashtu Deklaratën e ITUC dhe ETUC, datë 23.10.2019, miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i tyre.

Miratimi i kësaj Rezolute duhet të kuptohet nga çdokush, aktor, faktor apo qytetar i thjeshtë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si një instrument që nxit vendin tonë të adresojë sfidat dhe të vlerësoje rolin e pamohueshëm të patnerëve social në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të udhëhequr nga parime demokratike. Në mbështetje të proceseve integruese ne do ti kërkojmë Qeverisë Shqiptare të respektojë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të punonjësve, në përputhje me standartet ndërkombëtare, si dhe të sigurojë sundimin dhe zbatimin e ligjit dhe të promovojë modelin social european.

— Për sa më lart, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, si një aktor dhe faktor social potencial i bën thirrje Bashkimit European për të hapur procesin e negociatave për antarsimin e Shqipërisë në Bashkimin European, pasi hapja e procesit të negociatave garanton, siguron dhe adreson zgjidhjet ekonomike, sociale dhe politike të vendit tonë, përfshirë këtu edhe sindikatat si pjesë integrale e zgjidhjeve dhe zgjedhjeve në kuadër të këtij procesi.

Gjithashtu, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë i bën thirrje edhe Parlamentit European për të riformular politikën e zgjerimit të Bashkimit European, duke i kushtuar më shumë vëmendje të drejtave të punonjësve dhe mbrojtjes sociale, duke garantuar një përfshirje të plotë të sindikatave në këto procese.”

Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së